

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 27. 09. 2019

VENDIM

Nr. 46, datë 27. 09. 2019

**PËR
SHQYRTIMIN E VENDIMIT
NR. 50, DATË 20. 09. 2019 TË SENATI AKADEMIK**

Në zbatim të nenit 3 dhe 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në vendimin e Senatit Akademik nr. 50, datë 20. 09. 2019, gjatë mbledhjes së datës 27. 09. 2019 Bordi i Administrimit,

VËREN SE:

Pranë sekretarisë së Bordit të Administrimit është përcjellë vendimi nr. 50, datë 20.09.2019, i Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Në vendimin në fjalë Senati Akademik ka miratuar paraprakisht disa rialokime në planin buxhetor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin 2019 dhe përkatësisht:

a. Shtesa:

a.1. Zëri: Investime Artikulli 231 (09450) program i aktivitetit të përditshëm

a.1.1. Rialokim të fondeve për investime në zërin "Rehabilitim i katit nëntokë të Fakultetit të Shkencave Teknike" në vlerën 53, 924 lekë (000) mbështetur në shkresën nr 493/19 prot, datë 28.05.2019 të Sektorit të Shërbimeve me objekt "Relacion mbi Bodrumin e Godinës C", shkresën nr. 128/3 prot, datë 11. 07. 2019 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike me objekt "Kërkesë", si dhe Detyrën e Projektimit "Rehabilitim i katit nëntokë të Fakultetit të Shkencave Teknike".

a.1.2. Rialokim të fondeve për investime në zërin "Krijimi i Bibliotekës Digjitale të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë" në vlerën 30,000 lekë (000) mbështetur në shkresën nr. 1153 prot, datë 18.09.2019 të Sektorit të IT-së me objekt "Propozim për vazhdimësinë e Bibliotekës Digjitale të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë",

a.1.3. Rialokim të fondeve për investime në zërin "Blerje fond biblioteke" në vlerën 1,827 lekë (000) mbështetur në kërkesat e paplotësuara të fakulteteve për fond biblioteke.

[Four handwritten signatures in blue ink]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

2. Zëri: *Investime Artikulli 231 (09470) program i projekteve dhe kërkimit shkencor*
2. 1. Rialokim i fondeve për investime në zërin "Blerje mjete pune" në vlerën 1, 302 lekë (000) mbështetur në shkresën nr. 1145 prot, datë 17. 09.2019 të Koordinatorit të Projektit AFRIMED me objekt "Kërkesë për mbështetje financiare".

3. Zëri : *kërkim shkencor artikulli 602 (09470) program i projekteve dhe kërkimit shkencor*

3. 1. Rialokim të fondeve për investime në zërin "Shpenzime për aktivitete promovuese" në vlerën 1, 302 lekë (000) mbështetur në shkresën nr. 1147 prot, datë 17. 09. 2019 të Koordinatorit të Projektit "Business Club" me objekt "Kërkesë për rialokim të fondeve për mbështetje të aktiviteteve të UV në Projektin "Business Club" për Mbështetje financiare dhe vënie në dispozicion të një fondi mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave

b. Pakësime:

b.1. Zëri Investime Artikulli 231 (09450) program i aktiviteteve të përditshme


b.1. 1. Rialokimin e fondeve për investim për ngritjen e godinës së re të Fakultetit të Shëndetit në vlerën 84, 700 lekë (000) në zërat e investimeve të sipërpërmendura pasi në vitin buxhetor 2019 nga ana e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë nuk është konfirmuar "Letët premtimi/2 për mbështetje financiare për investimin kryesor të planifikuar në buxhetin e vitit 2019 "ngritjen e Godinës së Re të Fakultetit të Shëndetit Publik".

b. 2. Zëri : Investime Artikulli 230 (09450) bprogram i aktiviteteve të përditshëm

b. 2. 1. Rialokimin e fondit të vënë në dispozicion për këtë zë në vlerën 3, 799 lekë(000) në zërat e investimeve të sipërpërmendura si rezultat i mosrealizimit të investimeve të ngritjes së godinës së re të Fakultetit të Shëndetit Publik për vitin buxhetor 2019.

Bordi Administrimit pasi shqyrtoi materialet e dërguara pranë Tij si dhe materiale të tjera shtesë të vëna në dispozicion ditën e mbledhjes vuri re se:

1. Rialokimi i fondeve pakësime dhe shtesa kishte një diferencë prej 144.000 lekë të pa argumentuar se ku do të përdoret kjo diferencë. Gjithashtu pasqyrat financiare që prekin buxhetin si pasojë e rialokimit të fondeve, anëtarëve të B.A –së iu vendosën në dispozicion ditën e mbledhjes.
2. Për pikën a.1.1 -rialokimin e fondeve për investime në zërin "Rehabilitim i katit nëntokë të Fakultetit të Shkencave Teknike", ka:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

- mospërputhje të dukshme në vlerën e paraqitur në vendim dhe detyrës së projektimit të vënë në dispozicion ditën e mbledhjes.
 - mungonte preventivi me zërat e punimeve dhe projekti që do të zbatohej për këtë investim.
3. Për pikën a. 1.2 -rialokim të fondeve për investim në zërin "Krijim i Bibliotekës digjitale të UV", në shkresën e sektorit të IT, propozimi në fjalë vjen me specifitime për vazhdimësinë e pjesës së dytë të projektit për Krijimin e Bibliotekës Digjitale të Universitetit të Vlorës, ku(faqja 22) listohen pajisjet, programet dhe shërbimet dhe mungon kolon a e çmimeve për secilin prej zërave të përmendur.

Sikurse është cituar më lart, materiali propozues rezulton i paplotë, dhe më konkretisht për zërat investime të parashikuara, mungon projekti shoqërues, relacioni teknik, preventivat e nevojshëm dhe zërat si dhe cmimet për cdo zë të parashikuar sipas listës së cmimeve të miratuara nga VKM nr. 354, datë 11. 05. 2016 " Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" si dhe cmimet e referuar nga AKSHI <http://akshi.gov.al/legjislacion/>. Propozimi gjithashtu është i pashoqëruar me materialet justifikues nga drejtoritë përkatëse, apo organet dhe autoritetet që kanë propozuar vendimarrjen. U vu re se në materialin e paraqitur kishte paqartësi në shifrat e propozuara për investimin e "Rehabilitim i katit nëntokë të Fakultetit të Shkencave Teknike", ku në kërkesën për rialokim kërkohet vlera 53,924.000 lekë, ndërsa relacioni inxhinjerik parashikon si vlerë investimi një shifër 5.394.000 lekë, vlerë shumë herë më e ulët. E njëjta diskordancë në vlerë u konstatua dhe gjatë diskutimit me personat përgjegjës të propozimit. Gjithashtu vihet re se zëri për rialokim hiqet nga fondi parashikuar si bashkëfinansim për ngritjen e godinës së FSHP, investim ky strategjik për të cilin është prokuruar dhe projekti dhe janë bërë kërkesat për financim drejtuar pushtetit qëndror. Senati Akademik në vendimin e tij për rialokim fondesh, nuk merr parasysh dhe nuk sqaron se cdo të ndodhi me këtë investim strategjik? A do të konsiderohet më si i tillë, dhe nëse jo përse duhej prokuruar një projekt, kur në fund të vitit kërkohet rialokimi i fondeve të parashikuara si bashkëfinansim për realizimin e tij? Nëse po, kush do të jetë burimi i bashkëfinansimit në vijim.

Bordi Administrimit sipas parashikimeve të neneve 3, 47, 49 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili ka për qëllim kryesor mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare dhe administrative të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nisur nga kjo, B.A në vendim-marrjen e tij ka si qëllim kryesor garantimin e qëndrueshmërisë financiare të U.V- së.

Nga sa u parashtrua më sipër, në përfundim, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27.09.2019,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë propozimin për rialokim fondesh miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 50, datë 20.09.2019
2. Kopje e këtij Vendimi i përcillet Senatit akademik dhe Rektoratit.

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar

Dr. Ervis Moçka – Kryetar

